

STATUTI I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ITCONS" SHPK

Ne daten 10.05.2018 qytetin e Korcesduke u bazuar ne vullnetin e tyre te lire e te sinqerte, perpiluan statutin ne baze te ligjit 9901 date 14.04 2008 " Neni 230 pika 2 , Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare.

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot me daten 10.05.2018ne themeluesitkemi krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin "ITCONS" SH.P.K.

Themeluesit e shoqërisë janë:

- Ortaku **Z. Angelo Cardamone**, i biri i Enricos, lindur me 20.02.1965 ne Ascoli Piceno, Itali dhe banues ne Ascoli Piceno, Itali, identifikuar me Pasaporte italiane nr. YA0191492, perfaqesuar nga Gleni Allushaj me Prokure te Posacme Nr. 1681 Rep.- Nr. 1562 Kol. Dt.04.05.2018;
- Ortaku **Z. Klevis Furxhi**, i biri Vehbiut, lindur me 17.08.1983 ne Korce dhe banues ne Korce, Rruga Kristaq Prifti Lgj.15 P.20 A/7 Korce identifikuar me Karte Identiteti nr. 030212896, nr. Personal I30817071Q;
- Ortaku **Z. Gleni Allushaj**, i biri i Perparimit, lindur me 16.06.1980 ne Tirane dhe banues ne Tirane, Rruga "Muhamet Gjolllesha", Nd.57, H.2, Ap 2, Njesia Administrative Nr.7, 1001, Tirane, identifikuar me Karte Identiteti nr. 028791905. Dhe nr. Personal I00616080B;

Neni 2:


Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Shoqëria ka per objekt social, si ne shqiperi ashtu edhe jashte shtetit, aktivitetin e konsulences se kompanive te integruara me siper marrjet dhe/ose entitetet publike e private, me perjashtim eksplicit te cfaredo lloj aktiviteti profesional te rezervuar kategorive se profesionisteve te regjistruar ne regjistrat perkates. Aktiviteti i shoqerise eshte si me poshte:

Aktivitet kontraktor, ne vecanti:

- Asistence tekniko-juridike ne lidhje me aktivitetet tregtare, te shoqerive te se drejtes se punes dhe previdences sociale, te procedurave falimentare;
- Asistence, organizim, suport dhe koordinim teknik mbi problematikat juridike relative realizimit te proceseve te prodhimit, ne zbatim te projekteve te inxhinjerise



financiare dhe finances se kompanive, ne zgjidhje te mosmarrveshjeve te shoqerive dhe rregullimet e shoqerive;

- Analize te aspekteve tekniko-juridike dhe kontraktore ne lidhje me themelimin e shoqerive, entitete dhe/ose organizata, marreveshje partnership-i;
- Konsulenze dhe asistence kontraktuale ne permbylljen e marreveshjeve dhe/ose kontratave te natyres tregtare, te kompanive, te punes;
- Asistence tekniko-juridike (advisor) ne operacionet financiare te vecanta, te cilat kane te bejne me trasferimin e kompanive dhe/ose te kuotave shoqerore, bashkime te shoqerive, ndarjeve te shoqerive, pjesmarrje ne shoqeri dhe likuidime te shoqerive.

Sektori i kontabilitetit, ekonomik dhe administrativ, ne vecanti;

- Sherbime kerkimore dhe analize ekonomike dhe financiare ne sektorin e kreditimit, mbledhje informacioni mbi kapacitetet e kreditimit dhe sherbime ne lidhje me merkatet ne sektorin e aktiviteve te vleresimit mbi kapacitetin e kreditimit (Rating) ne lidhje me sipermarrjet, entitetet, shoqerite, organizatat, shoqatat dhe subjektet e tjera publike ose private si dhe te gjitha aktivitetet qe kane lidhje me sa me siper ashtu si kerkimet mbi aftesite paguese te instrumentave financiare te leshuara nga keto subjekte ose subjekte te ngjashme me to;
- Menaxhimin total te aktiviteve te kontrollit te brendshem, auditimit te brendshem, inspektimit per llogari te sipermarrjeve, entiteteve, kompanive, ndermjetesuesve financiare, shoqatave (Outsourcing) ose menaxhimin e pjeseshem te ketyre aktiviteve per llogari te subjekteve te sipermendura (Co-Outsourcing), si dhe menaxhimin ne outsourcing ose co-outsourcing te funksioneve te tjera te shoqerive si mund te jene asistenca dhe konsulenca ne fushe amministrative, financiare, monitorimi i rreziqeve te thesarit, implementime te sistemeve te risk menagment dhe kontrollit te brendshem si dhe te formimi menaxherial dhe profesionale;
- Konsulence teknike mbi sipermarrjet ne fushen tregtare dhe te financiare te kompanive, ketu perfshire edhe fushen e bashkimeve dhe blerjeve te shoqerive, dhe organizimin e strukturave te shoqerive finaciare, tregtare dhe industriale, si dhe analize e asistence ne vleresimin, shit-blerjen e sipermarrjeve, shoqerive, paketave aksionare ose pjesemarrjeve sociale, komplekse shoqerish, dege te shoqerive, prona te patundshme ose makineri, te ushtruara edhe nepermjet prokurave se perfaqesimit te paguar, si dhe aktiviteve te konsulences ne fushat e strukturimit dhe organizimit te operacioneve finaciare dhe leshimit te instrumentave finaciare;
- Sherbime revizionimi kontabel dhe sherbime te tjera te lidhura me aktivitetet e sipermarrjeve, entiteteve, kompanive, ndermjetesuesve financiare, shoqatave dhe subjektet e tjera publike ose private, aty ku keto subjekte nuk jane te detyruara nga ligji ne fuqi te kryejne revizion;
- Sherbime adresimi te shoqerive, perpunim te dhenash, mbajtje te kontabilitetit te kompanive, menaxhim te aktiviteve administrative si shvillim, mirembajtje dhe arkivim te te dhenave ne emer te te treteve, edhe te drejtuara publikut, sherbime te tjera mbeshtetjet dhe suportit, si dhe sherbime alokimi jo finaciar te software-ve, pajisje elektronike dhe aparate telekomunikimi.

Fusha e projektimit, mbi ambientin dhe kualitetin ne vecanti:

- Analize dhe konsulence ne fushen e sigurise se kompanive, te entiteve dhe/ose organizatave publike e private, formim te personelit te dedikuar dhe implementim te sistemeve te sigurise, edhe ne outsourcing;
- Analize dhe konsulence mbi drejtimin e kompanive ne lidhje me politikat ambientale te kompanive, vleresim dhe analize te impaktit ambientale te shoqatave dhe subjektet e tjera publike ose private;
- Analize dhe vleresim te sistemeve te certifikimit te kualitetit, implementim te sistemeve te certifikimit te cilesise dhe formim profesional te personelit te kompanive, shoqatave dhe subjektet e tjera publike ose private, si dhe konsulence dhe analize periodike, arritje dhe ruajtje te standarteve te cilesise;
- Projektim teknik dhe arkitektonik te projekteve civile dhe industriale, perpunim grafik, asistence ne aktivitetet e kantjereve te ndertimit, kontabilitet te punimeve, perllogaritje metrike;
- Projektim, prodhim dhe realizim, fillim e ngritje biznesi, miremajtje dhe menaxhim te sistemeve informatike, bazike dhe/ose aplikative, ne fushen e proceseve industriale, administrative, distributive dhe operative ne pergjithesi, dhe strategjite e konsulencat informatike per kompanite, sipermarrjet, entitetet, shoqerite, shoqatat dhe subjekte te tjera publike ose private;
- Menaxhim ne outsource te proceseve industriale, administrative, organizative dhe operative ne drejtim te kompanive, sipermarrjeve, entiteteve, shoqerive, shoqatave dhe subjekteve te tjera publike ose private ne fushen e informatikes, telematikes dhe telekomunikimeve, referuar edhe rrjeteve te ndryshme si internet, eternet dhe cfaredo mjete ose sistemi komunikimi;
- Sherbime konsulence dhe asistence software e te sistemeve informatike si projektim dhe realizim te faqeve internet, implementim te sistemeve te tregtise elektronike (e-commerce) nepermjet rrjeteve telematike, internet dhe menyra te tjera komunikimi dixhital e informatik.

Fusha drejtuese dhe menaxhim te risursave njerezore, ne vecanti:

- Organizim te kompanive, furnizim me sherbime konsulence dhe asistence profesionale per sa I perket rekrutimit dhe seleksionit te personelit, per riorganizimin e organigramave te shoqerive, te individuumit dhe personalizimit te instrumentave per rritje profesionale per personelin e punesuar;
- Formim dhe perditesim te personelit te punesuar, asistence dhe konsulence ne disiplinat e raportit te punesimit si dhe ne raportet kontraktore te punes duke iu referuar kontratave kolektive te punes te aplikuar ne kompanite tregtare;
- Perpunim te kontabilitetit te personelit dhe realizimet perkatese, asistence dhe konsulence ne redaktimin e projekteve formative te lidhura me raportet e punedhenies, asistence ne aktivitetet e entiteteve perkatese;
- Analize e asistence ne mosmarreshjet si pasoje e raporteve te punes individuale edhe/ose kolektive, analize edhe/ose verifikim te diferencave retributive, studim dhe/ose redaktim te konsulencave teknike si dhe asistence ne tentativat e pajtimit ne fushen e punedhenies;
- Sherbime informimi, konsulence, asistence, kerkimi dhe formimi ne pergjithesi, per kompanite, sipermarrjet, entitetet, shoqerite, shoqatat dhe subjektet e tjera publike ose private ne sektore te ndryshem ekonomik, financiare, prodhues, kontabel, organizativ, te menaxhimit dhe zhvillimit te burimeve njerezore, te planeve te marketingut te kompanive, te financimit etj;

- Sherbime projektimi, promovimi dhe realizimi te fushatave te komunikimit dhe publicitetit, te organizimit te conventave, seminareve dhe kurseve te studimit, si dhe studime dhe kerkime, hetime dhe sondazhe, edhe ne lidhje me tregun, me natyre sociale, ekonomike, kulturore, politike dhe tregtare dhe cfaredo lloj aktiviteti te lidhur me sa me siper. Ne fushat e permendura me siper per sa i perket publikimeve editoriale ne pergjithesi, edhe nepermjet perdorimit te suporteve elektronike, perhapja dhe trasmetimi i te dhenave dhe lajmeve, si dhe realizimi i analizave dhe kerkimeve ne fushat e lidhura me kategorite me siper dhe publikimi dhe shperndarja nepermjet cfaredo lloj sistemi komunikimi, me perjashtim kategorik publikimet e gazetave e revistave. Ne permbushje te objektit social, shoqeria mund te perdore punen e sipermarrjeve dhe profesionisteve me kompetenca specifike ne sektoret e tyre te aktivitetit.

- Shoqeria mund te japi dhe te marre sherbime agjencore, komisione, perfaqesime, me ose pa depozite, dhe mandate, te bleje, perdore dhe trasferoje licenca e patenta industriale si dhe cfaredo lloj pune qe ka te beje me shpikje, kerkime tregu dhe perpunim te dhenash per llogari personale ose per llogari te te treteve, te leshoje e te marre licenca shfrytezimi tregtar (edhe franchising) si dhe tekryeje te gjitha sherbimet tregtare (edhe import-eksport), financiare, te luajtshme e te paluajtshme, te domosdoshme per te arritur qellimin e objekteve sociale. Saktesohet qe shoqeria mund te perdore cdo mjet qe ka lidhje me aktivitetet e subjekteve te sipermendura ne kete objekt qe do te kete nevoje, per funksionimin e tyre, per nderhyrjen e eksperteve ose profesionisteve te pajisur me titujt profesional te nevojshem dhe te licensuar nga dhomat profesionale te posacme, ose personel te pajisur me tituj dhe kualifikime, Aktivitetet e mesiperme do te mbesheten ne punen e ketyre profesionisteve qe do te mbajne pergjegjesi te drejteperdrejte personale ne lidhje me te tretet.

- Shoqeria, ne rruge jo kryesore por ne rruge strumentale, per te ndjekur objektin social, mund te kryeje cfaredo lloj operacioni komercial, industrial, mobiliar dhe/ose imobiliar qe kane lidhje me objektin e veprimtarise qe vleresohet nga organi administrativ e nevojshme per arritjen e objektit social. Mund te marre, si drejtperdrejt si ne menyre indirekte, pjesemarrje ne kompani te tjera, partneritete dhe ente me objekt te ngjashem ose analog, brenda limiteve te lejuara nga ligji, te jape borxhe, afatmesem ose afatgjate dhe te lejoje fidejusione, te kryeje dorezani, te lejoje bllokime ipotekare mbi pronat e veta te paluajtshme edhe si garanci per detyrimet e te treteve. Aktivitetet me karakter financiar dhe kuota duhet, sidoqofte, te jene ne funksion te arritjes se objektit te aktivitetit social te kompanise.;

- Te gjitha keto aktivitete duhet te zhvillohen ne kufijte e respektit te normave dhe ligjeve qe dispijnojne ushrimin si dhe ne respektin e pergjithshem te akteve ligjore ne fushat e aktiviteteve te rezervuara per kategorite e profesionisteve te regjistruar ne kolege, dhoma profesionale etj. Saktesohet qe shoqeria mund te perdore cdo mjet qe ka lidhje me aktivitetet e subjekteve te sipermendura ne kete objekt qe do te kete nevoje, per funksionimin e tyre, per nderhyrjen e eksperteve ose profesionisteve te pajisur me titujt profesional te nevojshem dhe te licensuar nga dhomat profesionale te posacme, ose personel te pajisur me tituj dhe kualifikime, Aktivitetet e mesiperme do te mbesheten ne punen e ketyre profesionisteve qe do te mbajne pergjegjesi te drejteperdrejte personale ne lidhje me te tretet.

Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve sipas kushteve për ndryshimin e Statutit.

Neni 3:

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me afat te papercaktuar.

Neni 4:

Selia

Selia e Shoqërisë është në Korce, Rruga "Midhi Kostani", Godina "City Center", Kati II, Korce, Shqiperi.

Adresa e faqes se internetit te shoqerise eshte _____

Kreu II

Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 10.000 Lek (dhjete mije leke). Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues: Angelo Cardamone, Zoterues i 1 (nje) kuote me vlerë 3.400 (tremije e katerqind) Lekeqë përben 34% (tridhjetë e kater perqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë;
2. Ortaku themelues: Klevis Furxhi, Zoterues i 1 (nje) kuote me vlerë 3.300 (tremije e treqind) Lekeqë përben 33% (tridhjetë e tre perqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë;
3. Ortaku themelues: Gleni Allushaj, Zoterues i 1 (nje) kuote me vlerë 3.300 (tremije e treqind) Lekeqë përben 33% (tridhjetë e tre perqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.



Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakut është organi i vetem vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakut është organi i vetem vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakut është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve

- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyqruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 12

Përfshirja nga e drejta e votës

1. Ortaket nuk mund të ushtrojnë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaket përfaqësohen nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorit(ve) prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

Administratorii parë i shoqërisë deri në emërimin e tij nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshmedo të jete:

Të dhënat e identifikimit:

Specimeni i nënshkrimit:

Gleni Allushaj



Neni 14

Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqëson shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

- d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raporton përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori është i detyruar të thasë Asamblyne e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

-Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose

solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërmdan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV

Viti financiar-ekspertet

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrolltet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrolltet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

Kreu V

Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “Shoqëri ne likuidim e siper”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

Per mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqërisë dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

**ORTAKET
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"ITCONS" shpk**


ANGELO CARDAMONEperfaqesuar nga Gleni Allushaj me Prokure te Posacme
Nr. 1681 Rep.- Nr 1562 Kol. Dt.04.05.2018;

Gleni Allushaj 

KLEVIS FURXHI

Klevis Furxhi 

GLENI ALLUSHAJ

Gleni Allushaj 

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE KORÇE

NR. 1681 REP.
NR. 1562 KOL.

Taksa e pulles e paguar
depozituar ne zyren e noterise



PROKURE E POSACME

Sot me daten 04.05.2018 (dymije e tetembehjete) ne zyren e noterise Korce ne Rrugen 28 Nentori, Perballe Deges se Tatim Taksave, para meje Bledar Zake, noter u paraqit :

POROSITES

Angelo Cardamone datelindje 20.02.1965 madhor i afte per te kryer veprime juridike i identifikuar prej meje me ane te pasaportes me nr YA0191492. Shtetas Italian i cili nuk njeh dhe flet gjuhen shqipe u njoh me permbajtejn e prokures nga noteri nepermjet gjuhes italiane dhe angleze.

BAZA LIGJORE: Neni 64 e vijues te Kodit Civil te Shqiperise, ligji Nr. 7829, date 01.06.1994 "Per Noterine", legjislacioni i fushes ne fuqi.

I perfaqesuari eshte madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar i cili kerkoi nga une redaktimin e kesaj prokure te posacme, si me posht vijon:

Une, i perfaqesuari me ane te kesaj prokure emerj si perfaqesues me tagra te plota Z. Gleni Allushaj i datelindjes 16.06.1980 me pasaporte nr BC5134969 dhe me nr personal I00616080B te cilit i jap te drejte dhe kompetence te plote ligjore, qe te **nenshkruaje statutin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar per pjesen e kuotes se kapitalit themeltar qe me takon e cila perben 34% te kapitalit themeltar te shoqerise** si dhe te kryeje te gjitha veprimet ligjore per perpilimin e Statutit te Shoqerise, Aktit te Themelimit dhe te kryeje Rregjistrimin Fillestar ne QKB si dhe me pas te kryeje veprimet ne lidhje me marredheniet financiare dhe juridike te shoqerise nga rregjistrimi i saj ne QKB, Tatime e Insitucione te ndryshme deri ne administrimin e saj te perditshme te aktivitetit tregetar.

Perfaqesuesi ka te drejte e kompetence te plote te paraqitet perpara cdo institucioni te administrates qendrore dhe vendore si:

1. QKB, per rregjistrimin fillestar te shoqerise, per rregjistrime te ndryshme te shtimit te objektit te veprimtarise apo ndryshime adrese, rritje kapitali, caktimi eksperti kontabel etje.
2. Te paraqitet ne asamblene e ortakeve te Shoqerise per te marre vendimet e nevojshme qe do te duhen per administrimin e perditshem te shoqerise.
3. I porosituri te kete te drejte te paraqitet ne cdo kohe prane Drejtorise Rajonale te Tatim Taksave per te dorezuar deklarata, marre vertetime, dorezuar kerkesa, dorezuar bilance kontabel, bere rakordime me deklarimet apo per te kryer cdo korrespondence apo marredhenie te nevojshme per ecurine e aktivitetit.
4. Te paraqitet prane insitucioneve te ndryshme si zyra e punes, Inspektoriati shteteror i punes, Instituti i sigurimeve shoqerore dhe shendetsore per dorezim kerkesash per marrje (apo largim) punonjesish ne (nga) puna, marrje vertetimesh, dorezim kerkesash etj.
5. Po keshtu i porosituri prej meje ka te drejte te paraqitet prane c'do banke te nivelit te dyte ne Republiken e Shqiperise ku te kryeje cdo veprim te nevojshem bankar per mbarevajtjen financiare te aktivitetit, te kryeje veprime me llogarite bankare si debitime e kreditime, te beje lajmerime te autorizojte transferta brenda banke dhe jashte banke, te beje kembim valutor, pagesa tatim taksash dhe cdo transakcion te mundshem prane cdo banke tjeter te nivelit te dyte ku shoqeria ka llogari bankare. I porosituri prej meje te kete te drejte te beje transferta per llogari te buxhetit, thesari, tatimet, dogana, likujdim fatura per furnitoret, kalim pagash .
6. I porosituri te kete te drejte te beje pagesa prane sherbimeve utilitare si oshee , ukt , etj .
Vec sa siper, eshte i autorizuar te me perfaqesoje edhe ne te gjitha mardheniet qe mund te krijohen me organet e ndryshme administrative e te shtetit, dhe cfaredo lloj institucioni qofte, perfshire ketu Arkiva, Bashki e Komuna, etje, me te cilat ata mund te komunikojte me qellim qe te mbledhe te dhena shkresore e administrative ose ne lidhje me marrjen e dokumentave te nevojshme apo kryerjen e veprimeve te nevojshme te cilat mund ti perdore si prova per vertetimin e pretendimeve qe do te mbroje ne gjykim, perfshire noterizime te dokumenteve ne nje zyre noterie. Te gjitha veprimet qe do te kryejne perfaqesuesi ne emer dhe per llogarine time brenda tagrave te kesaj prokure i konsideroj te mireqena sikur te kem qene vete present personalisht dhe ti kem kryer vete ato. Efektet e kesaj prokure jane pa afat.

Sa siper, Prokura e cila u perpilua e redaktua, konform vullnetit te te Perfaqesuarit, ne tre kopje me vlere te njejte ligjore, nga une Noter Bledar Zake, te cilit, pasi ja lexova me ze te larte dhe te qarte, ishte plotesisht dakort me permbajtjen e prokures dhe e nenshkruan ate para meje.

Une Noteri, vertetoj teresisht aktin dhe nenshkruaj ne baze te ligjit.

POROSITES

ANGELO CARDAMONE



NOTER

BLEDAR ZAKE

